



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Printijeni/Prodato Received/Delivery	24-05-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3012/2022		115



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.307/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.307/2022 të datës 29.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.05.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën e datës 25.02.2022, të parashtruar nga ankuesi

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet te njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, pranë Agjencionit të Kosovës për Produkte Medicinale, sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit me numër të protkollit 1220 , të datës 28.04.2014 në pozitën "Zyrtar i Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale".

Me datën 07.11.2014 Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.83/14, sipas të cilit Inspektorati Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale transferohet prej Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në Inspektoratin Shëndetësor të

Ministrisë së Shëndetësisë. Ndërsa me datën 13.03.2015, Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.50/2015 sipas të cilit e ka ndryshuar Vendimin me numër 47/15 të datës 03.03.15 me numër të protokollit 05-1189 të Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe është plotësuar në lidhje me atë se Inspektorati Farmaceutik është organ administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankuesi vazhdimisht pas këtij veprimi ka parashtruar kërkesa dhe ankesë në institucionin e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me dëmtimin në pagë, pas ndërrimit të kodit buxhetor lidhur me mos marrjen e shtesës në vlerën prej 30% të pagës si staf i këtij agjencioni, mirëpo që sipas ankuesit, vetëm ky nuk është rikthyer në kodin e mëparshëm buxhetor lidhur me realizmin e kësaj shtese, ndërsa kolegët tjerë e kanë realizuar.

Përsëri me datën 24.02.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë-kërkesë tek Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë për mos dëmtim të pagës lidhur me këtë çështje, mirëpo Divizioni për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje për ankuesin.

I pakënaqur me mos përgjigje nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, me datën 29.03.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1665/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i njëjti është dëmtuar në pagë si personel i Inspektoratit Farmaceutik për shkak të ndërrimit të kodit buxhetor pas transferimit të Agjencionit të Kosovës për Produkte Medicinale në Ministrinë e Shëndetësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1920/2022 për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datën 14.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.05.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.41/2022, me të cilin ka vendosur lidhur me vazhdimin e afatit për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1665/2022 të datës 29.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 25.02.2022 për tek Ministria e Shëndetësisë; Kërkesën e ankuesit të datës 25.09.2018, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë për nivelizim të pagës; Ankesën e ankuesit të datës 14.10.2015 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën e ankuesit të datës 14.02.2018 për nivelizim të pagës; Ankesën-Kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2017 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; E-mailin zyrtar të datës 04.12.2017; Kërkesën e ankuesit për nivelizim të pagës të datës 21.11.2017; Kërkesën për mos dëmtimin e të ardhurave të IFPMM-së të datës 07.09.2015; E-mailin zyrtar të datës 20.11.2017; Kërkesën e datës 21.11.2017 për nivelizim nga ankuesi për Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimin me numër 05-1373 të datës 13.03.2015 nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin me numër 05-6418 të 10.11.2014 nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën për nivelizim të pagës të datës 14.02.2018 nga ankuesi për tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së

Shëndetësisë; E-mailin zyrtar të datës 04.12.2017; Ndryshim plotësimin e akt emërimit të ankuesit me numër 1220 të datës 28.04.2014 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 25.04.2014; Vendimin me numër 535/1 të datës 14.03.2014 nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKPM-së; Vendimin me numër 535 të datës 26.02.2014 lidhur me emërimin e komisionit përzgjedhës për pozitën zyrtar i inspektoratit farmaceutik; Akt emërimit të ankuesit me numër 161 të datës 06.02.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.04.2022 nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankuesit të datës 14.10.2015 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Shkresën zyrtare të datës 05.11.2018 me numër 05-7384/2 lidhur me dokumentacionin sipas kërkesës nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën e ankuesit të datës 26.10.2018 për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.04.2022 nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën-kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2018 me numër 05-8908 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Formularin e bordit për licencim të institucioneve të kujdesit primar shëndetësor; Shkresën zyrtare me numër 05-7384/2 të datës 05.11.2018 nga Ministria e Shëndetësisë për Këshillin; Kërkesën për prova shtesë të datës 10.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Ministrinë e Shëndetësisë; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.05.2022 nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me provat shtesë për Këshillin; Listat e pagave për muajin qershor dhe korrik të vitit 2015, muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021 si dhe janar, mars dhe shkurt të vitit 2022 nga Ministria e Shëndetësisë; Vendimin VK.nr.41/2022 të datës 10.05.2022 për shtyrjen e fatit të ankesës së ankuesit nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për organin punëdhënës, respektivisht udhëheqësin më të lartë administrativ në Ministrinë e Shëndetësisë, që ti ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën e datës 25.02.2022 e parashtruar nga ankuesi

SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se Njësia për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë nuk e ka shqyrtuar e pastaj adresuar kërkesën me numër protokollit 05-431 të datës 25.02.2022 të parashtruar nga ankuesi, respektivisht nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativ-juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën në organin kompetent për realizimin e të drejtës së pretenduar të ankuesit lidhur me dëmtimin në pagë me bazën prej 30 % të shtesës mbi pagën bazë, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se zyrtari përgjegjës i Njesisë për Burime Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë me rastin e mos shqyrtimit dhe adresimit të kërkesës së ankuesit, nuk ka vepruar në harmoni me nenin 135 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"1.Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"*, nga se është obligim zyrtarë i organit kompetent të punësimit që në afate ligjore të trajtojnë kërkesat e ndryshme



dhe të nxjerrët akt administrativë si parashohin dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me kërkesën-ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës: *1.Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin kompensim të pagës në këto raste: 1.8. kompensim në rast të perfeksionimit profesional të specializuar për nevojat e organit ose të shtetit....."*. Ndërsa me dispozitat e nenit 13 paragrafin 4 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve, është përcaktuar procedura dhe mënyra e kompensimit lidhur me këtë fushë.

Andaj, duke marrë parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, është i obliguar që të ndër marr veprime ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen në lidhje me kërkesën e datës 25.02.2022 , të parashtruar nga ankuesi në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike mbi bazë të një gjendje reale juridike lidhur me atë se a ka bazë ligjore sa i përket këtij pretendimi si dhe të konstatoj saktë situatën sa i përket çështjes lidhur me atë se nëpunësit tjerë të këtij inspektorati të nivelit të njëjtë a e realizojnë shtesën prej 30% mbi vlerën e pagës bazë dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.307/2022, datë 24/05/2022

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.